



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE FURNIZIMIT ME UJE DHE
LARGIMIT E PERPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 54, datë 14.04.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 71, DATË 21.09.2018, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SEANCËS DËGJIMORE ME
PUBLIKUN NË PROCESIN E MIRATIMIT TË TARIFAVE”

Në mbështetje të pikës “e” dhe “i” të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 71, datë 21.09.2018, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave” të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 6.2 të ndryshohet: Operatorët që në zonën e tyre të shërbimit mbulojnë më shumë se një bashki duhet të organizojnë seancë dëgjimore të veçantë me publikun për secilën bashki në zonën e shërbimit.
- Të shtohet pika 6.3: Seanca dëgjimore duhet të zhvillohet sa më afër qendrës së qytetit për të lehtësuar dhe nxitur një pjesëmarrje sa më të gjerë të publikut.

2. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike dhe të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani